

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7826
E enjte, 4 korrik 2024
Çmimi 0.50 €

Më pak çifte të kurorëzuara në vitin 2023 sesa një vit më parë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LAMTUMIRË ISMAIL KADARE!

FAQE 4-5



Të mërkurën, në varrezat e Tufinës në Tiranë, i është dhënë lamtumira e fundit shkrimtarit të madh Ismail Kadare. Ceremonia e varrimit u zhvillua në një rreth të ngushtë familjar, me kërkesë të familjes së

tij. Ndërkaq udhëheqës të lartë dhe qytetarë të shumtë nga vende të ndryshme bënë homazhe pranë arkivolit të shkrimtarit Ismail Kadare në hollin e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit në

Tiranë, i cili vdiq në moshën 88-vjeçare. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në fjalën që mbajti gjatë ceremonisë shtetërore në nderim të Kadaresë, tha se ai i përket gjithë botës

QEVERIA PËR TAKIMIN NË BRUKSEL: SERBIA REFUZON TA PRANOJË MARRËVESHJEN BAZIKE NË TËRËSI DHE NUK PRANON TË ZBATOJË PJESË TË SAJ F. 4



"ISHIM DHE DO TË JEMI ME KOSOVËN", AMBASADA AMERIKANE FESTON 248-VJETORIN E PAVARËSISË SË SHBA-së F. 5



NËNSHKRUHET KONTRATA PËR FINANCIMIN E FESTËS SË VJELJES SË RRUSHIT "HARDH FEST 2024" F. 8

SPORT



EDHE TRE SPORTISTË NGA KOSOVA DHE KATËR NGA SHQIPËRIA NË 'PARIS 2024' F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Sondazhi: Një në tre demokratë mendon se Bideni duhet të dalë nga gara

WASHINGTON, 3 KORRIK - Një në tre demokratë mendon se presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, duhet t'i japë fund garës për rizgjedhje, pas debatit të javës së kaluar me kundërkandidatin republikan Donald Trump, por gati asnjë demokrat tjetër nuk performon më mirë se Bideni në një përballje hipotetike me Trumpin, tregon një sondazh i agjencisë së lajmeve "Reuters" dhe kompanisë së kërkimeve "Ipsos". Sondazhi dyditor që u mbyll të martën, zbuloi se Trumpi, 78 vjeç, dhe Bideni, 81 vjeç, ruajnë mbështetjen e 40 % të votuesve të

regjistruar. Dita e zgjedhjeve është më 5 nëntor. Ndër emrat e demokratëve kryesorë të vënë para të anketuarve, vetëm Michelle Obama, gruaja e ish-presidentit demokrat Barack Obama, ia kaloi Bidenit dhe doli në epërsi me 50 % mbështetje, kundrejt Trumpit me 39 %. Zëvendëspresidentja Camala Harris, për shembull, mori 42 % mbështetje, kundrejt Trumpit 43 %. Michelle Obama, autore e librit më të shitur në vitin 2018 "Becoming", ka thënë vazhdimisht se nuk do të garojë për presidente.

Rreth 32 % e demokratëve në sondazh kanë thënë se Bideni duhet të heqë dorë nga gara për rizgjedhje pas debatit të 27 qershorit. Në atë debat Bideni ka belbëzuar gjatë gjithë kohës dhe nuk ka arritur t'i sfidojë sulmet e Trumpit, të cilat, në shumë raste, kanë përfshirë pretendime të rreme. Vetë Bideni ka pranuar se nuk ka pasur paraqitje të mirë gjatë debatit me Trumpin, por ka thënë se rizgjedhja e tij "do ta shkatërronte demokracinë". Ai është zotuar se do të mbetet në garë.



Tërheqje masive e kandidatëve në Francë për ta ndalur Tubimin Kombëtar

PARIS, 3 KORRIK - Partitë opozitare në Francë bënë disa marrëveshje të nxituara në përpjekje për ta bllokuar fitoren bindëse të partisë së ekstremit të djathtë, Tubimi Kombëtar, në rrethin e dytë të zgjedhjeve më 7 korrik. Tubimi Kombëtar i Marine Le Penit siguroi më shumë vota në raundin e parë të zgjedhjeve të parakohshme legislative që u mbajt më 30 qershor, por jo mjaftueshëm për ta formuar qeverinë. Një numër i paprecedentë kandidatësh që u kualifikuan për raundin e dytë nga aleanca e krahut të majtë, Fronti i Ri Popullor, dhe nga koalicioni i qendrës i presidentit



Emmanuel Macron, u tërhoqën, për t'i dhënë mbështetje kandidatit që ka më shumë gjasa të fitojë përballë kundërkandidatit nga

Tubimi Kombëtar. Në mesin e atyre që e braktisën garën janë edhe disa ministra të kabinetit.

Sipas një numërimi të bërë nga gazeta franceze "Le Monde", rreth 218 kandidatë që do të mund të konkurronin në raundin e dytë janë tërhequr. Prej këtyre, 130 ishin të majtë dhe 82 të qendrës. Kandidatët kishin kohë deri në orën 18:00 të martën për t'u tërhequr. "Më duhet ta parandaloj Tubimin Kombëtar që të arrijë shumicë absolute në Asamblenë Kombëtare, sepse do të ishte - dhe e them nga thellësia e zemrës - do të ishte e tmerrshme për vendin dhe francezët", tha kryeministri francez Gabriel Attal. Macron e shpërndau Asamblenë Kombëtare dhe i thirri zgjedhjet e

parakohshme më 9 qershor, pas fitores së Tubimit Kombëtar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian. Në raundin e dytë të zgjedhjeve legislative, Tubimi Kombëtar synon të sigurojë një shumicë absolute në Asamblenë Kombëtare me 577 ulëse. "Ne nuk mund të pranojmë të hyjmë në qeveri nëse nuk mund të veprojmë", tha Le Pen në një intervistë për transmetuesin publik "France Inter". Nëse Tubimi Kombëtar e siguron mbështetjen që synon, Franca do të kishte qeverinë e parë të ekstremit të djathtë që nga Lufta e Dytë Botërore.

NATO-ja do të dërgojë emisar të përhershëm special në Ukrainë



BRUKSEL, 3 KORRIK - Vendet anëtare të NATO-s vendosën të dërgojnë një emisar special në Kiev për ta zgjeruar praninë civile të aleancës ushtarake perëndimore në Ukrainë, konfirmoi një zëdhënës për agjencinë e lajmeve DPA. Zytari i lartë do ta ketë për detyrë ta koordinojë mbështetjen politike dhe praktike të aleancës në terren derisa Ukraina vazhdon të luftojë kundër pushtimit rus. Lajmi vjen përpara samitit të

NATO-s në Uashington, që do të mbahet nga data 9 deri më 11 korrik. Në atë samit udhëheqësit pritet të miratojnë zyrtarisht një plan për koordinimin e ndihmës ushtarake për Ukrainën, për herë të parë në një mision zyrtar të quajtur Ndihma për Siguri dhe Trajnime e NATO-s. Tash për tash është e paqartë se kush do të caktohet në postin e ri në Kiev. Detaje të mëtejshme do të

zbulohen pas përzgjedhjes zyrtare, tha zëdhënësi, duke i konfirmuar planet e raportuara më herët nga "Wall Street Journal". NATO-ja, përndryshe, ka përfaqësim zyrtar në Kiev për gati një dekadë, që përfshin një zyrë ndërlidhëse dhe një qendër informacioni dhe dokumentacioni, e cila ekziston që nga fundi i viteve 1990. Ai trajton, mes të tjerash, kontaktet me ministrinë dhe autoritetet ukrainase.

Mbi 120 njerëz të vdekur nga ikja në rrëmujë në Indi

NJU-DELHI, 3 KORRIK - Së paku 121 njerëz humbën jetën nga ikja në rrëmujë në Indinë veriore, thanë zyrtarët atje. Incidenti ndodhi në një tubim fetar të martën në qarkun Hathras të shtetit Utar Pradesh. Viktimat, përfshirë një numër të madh të grave dhe disa fëmijë, janë ende duke u identifikuar. Nuk është ende e qartë se çfarë e shkaktoi

rrëmujën. Disa dëshmitarë thanë se dalja ishte shumë e ngushtë dhe kur njerëzit po largoheshin, një stuhi e fortë pluhuri shkaktoi panik, duke bërë që njerëzit të nguteshin, të rrëzoheshin dhe ta shkelnin njëri-tjetrin. Incidencë të ngjashme ndodhin herë pas here në Indi, pasi turma të mëdha njerëzish mblidhen në hapësira të

ngushta, ku nuk respektohen masat e sigurisë. Në vitin 2018 rreth 60 njerëz humbën jetën kur një tren u përplas për një turmë që po ndiqte një festival hindu në shtetin Punxhab. Në vitin 2013, nga ikja në rrëmujë në një festival tjetër hindu në shtetin qendror, Madhia Pradesh, humbën jetën 115 njerëz.



Lamtumirë Ismail Kadare!



Të mërkurën, në varrezat e Tufinës në Tiranë, i është dhënë lamtumira e fundit shkrimtarit të madh Ismail Kadare. Ceremonia e varrimit u zhvillua në një rreth të ngushtë familjar, me kërkesë të familjes së tij. Ndërkaq udhëheqës të lartë dhe qytetarë të shumtë nga vende të ndryshme bënë homazhe pranë arkivolit të shkrimtarit Ismail Kadare në hollin e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit në Tiranë, i cili vdiq në moshën 88-vjeçare. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në fjalën që mbajti gjatë ceremonisë shtetërore në nderim të Kadaresë, tha se ai i përket gjithë botës

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

TI RANË, 3 KORRIK - Shkrimtari shqiptar Ismail Kadare u varros më 3 korrik në varrezat e Tufinës në Tiranë. Ceremonia e varrimit u zhvillua në një rreth të ngushtë familjar, me kërkesë të familjes së tij. "Jemi shumë të prekur nga gjithë kjo dashuri. Ai është ngritur në panteonin e gjenive të botës. Një nga mënyrat për t'i bërë homazhe është t'i lexojmë përsëri veprat e tij", tha vajza e shkrimtarit, Besiana Kadare.

Kadare vdiq më 1 korrik, në moshën 88-vjeçare, pas një arresti kardiorespirator.

Paraditen e së mërkurës arkivoli me trupin e tij u vendos në hollin e Teatrit Kombëtar të Operës dhe

Baletit në Tiranë, ku qytetarë të shumtë nga vende të ndryshme bënë homazhe.

I pranishëm ishte edhe një delegacion i Kosovës në krye me presidenten Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti dhe kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në fjalën që mbajti gjatë ceremonisë shtetërore në nderim të Kadaresë, tha se ai "i përket gjithë botës". "Kadare jetoi si dëshmitar i një fjale për të cilën mori tërë lëvdatat dhe nderimet e mundshme të botës dhe tërë smirën dhe sharjet e mundshme të vendit që e lindi. Nuk e mori Çmimin Nobel, por mbeti i vetmi kandidat për të cilin ka një dosje letrash anonime nga

bashkatdhetarët e tij. Ai erdhi, shkroi dhe iku. Ne i kemi vetëm një detyrim: t'ia respektojmë ikjen", tha Rama.

Presidentja Vjosa Osmani tha se me zemër të rënduar i thanë lamtumirë penës së shquar dhe kolosit të papërsëritshëm, fjalët e të cilit kapërcyen kufijtë, kulturat dhe kohën. "Për dekada të tëra veprat e Ismail Kadaresë ndriçuan cepat më të errët të historisë dhe shpirtit njerëzor. Aftësia e tij për ta gërshetuar historinë, mitet dhe realitetin, e bëri zërin e tij një nga më të veçantët dhe më të fuqishmit në letërsinë bashkëkohore. Prandaj, jemi përgjithmonë mirënjohës për veprat që na la. Liria e Kosovës për të ishte triumfi i kombit shqiptar. Ndërkaq, për kombin shqiptar,

vetë ekzistenca dhe vepra e Ismail Kadaresë është triumf i kulturës mbi injorancën dhe i lirisë mbi diktaturën. Lamtumirë, titani i letërsisë, Ismail Kadare!", ka theksuar Osmani

Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se Kadare i dha aq shumë kombit shqiptar, e për këtë të gjithë do të jemi gjithnjë mirënjohës, ndërsa përmes tij populli shqiptar i dha botës një gjeni të letërsisë, e për këtë do të jemi gjithnjë krenarë, ne dhe brezat që do të vijnë. "Dhimbja për ikjen e tij është shumë e madhe, por ai do të jetë mes nesh i paharruar, me krijimtarinë e tij që do të mbetet e pavdekshme në letërsinë botërore! Me veprën e tij ai zgjeroi gjuhën, mprehu perceptimet dhe stërholoi ndijimet, ndezi imagjinatën e formësoi përfytyrime për të gjithë popullin tonë. Figurat, frazat, vargjet dhe personazhet e tij janë tashmë referenca kolektive të mendimit dhe shqisave tona artistike si komb. U prehtë në paqe e përjetësi, aty ku do të shndrisë duke i bërë dritë të gjithë botës!", ka deklaruar Konjufca.

Kryeministri i Kosovës, Kurti, shkroi në librin e kujtimeve për

Kadarenë se "pikëllimi është i thellë, sepse admirimi është i lartë". "Historia (me gjithë mitet), politika (me gjithë intrigat), gjuha (me gjithë bukurinë) me romanet dhe poezitë e Ismail Kadaresë u bënë dije dhe vetëdije për popullin tonë. Lum ne që e patëm, kaq shumë. Vepra e tij do të rrojë gjatë, jo vetëm për ne", shkroi Kurti, transmeton Zyra e tij. Shqipëria ishte në zi kombëtare dy ditë, e Kosova një ditë.

Veprat e Kadaresë u përkthyen në më shumë se 45 gjuhë të botës.

Tridhjetë vjet të karrierës së shkrimtarit ai i jetoi në Shqipërinë komuniste, ku edhe shkroi kryeveprat: "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Prilli i thyer", "Dimri i madh" e "Ura me tri harqe".

Në vitin 1990 emigroi në Francë, pasi bëri deklaratën në favor të demokratizimit.

Kadare ishte fitues i disa çmimeve ndërkombëtare, ndërsa vitin e kaluar Franca i dha titullin "Oficeri i Madh i Legjionit të Nderit".

Udhëheqës në Shqipëri dhe në Kosovë thanë se me vdekjen e Kadaresë, "shqiptarët humbën gjenin e tyre të letrave", ndërsa "bota humbi shkrimtarin e saj më të madh të gjallë".



Qeveria për takimin në Bruksel: Serbia refuzon ta pranojë Marrëveshjen Bazike në tërësi dhe nuk pranon të zbatojë pjesë të saj

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka dhënë hollësi për takimin e fundit të kryenegociatorit Besnik Bislimi që pati me emisarin special të dialogut, Miroslav Lajçak dhe kryenegociatorin serb Petar Petković. “Në takimet në nivel të kryenegociatorëve, ku delegacioni i Kosovës kryesohej nga zëvendëskryeministri i parë për

Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, u diskutua mbi formalizimin e Marrëveshjes Bazike, si element kryesor dhe i parë për zbatim të sekuencuar të marrëveshjes, bashkë me aneksin e Ohrit, mbi Planin e Sekuencimit, zbatimin e Marrëveshjes së Energjisë, rreth mungesës së përparimit në zbatimin e Deklaratës për personat e zhdukur me dhunë, si dhe zbatimin e një numri marrëveshjesh të tjera, përfshirë IBM, si dhe atë për vizitat

e zyrtarëve. Nga diskutimet, sidomos në dy pikat e para, u ekspozua sërish fakti tashmë i konfirmuar disa herë dhe publikisht që Serbia refuzon të pranojë Marrëveshjen Bazike në tërësi dhe nuk pranon të zbatojë pjesë të saj”, është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës. Më tej thuhet se pala serbe refuzoi të përfshihet në diskutim për dakordimin e planit të sekuencimit si dhe arritjen e formalizimit të marrëveshjes bazuar në garancitë

e kërkuara në takimin e liderëve javën e kaluar. “Diskutimi rreth çështjes së personave të zhdukur ekspozoi sërish që pala serbe është duke e sabotuar procesin, duke nxjerrë vazhdimisht kërkesa të reja me qëllim të bllokimit të procesit. Ndërkohë, zvarritje në zbatim nga ana e Serbisë janë evidentuar nga kryenegociatori i Kosovës edhe në Marrëveshjen e Energjisë”, është thënë në njoftimin për medie. Ky takim që zgjati më shumë se 6 orë, nisi me takime bilaterale,

ndërsa u përmbyll me takim trepalësh. “Vazhdimi i procesit mbetet tek përpjekja për të gjetur rrugën përpara në arritjen e dakordimit rreth formalizimit dhe planit të sekuencimit për zbatimin e plotë të Marrëveshjes Bazike të cilën BE-ja e ka shpallur si ligjërish të obligueshme në tërësinë e saj dhe aneksit të zbatimit, që pikë fillestare duhet ta ketë formalizimin e marrëveshjes mes palëve”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



Komisioni Evropian njofton për paketën e gjashtë të investimeve për Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 3 KORRIK - Komisioni Evropian (KE) ka njoftuar për paketën e gjashtë të investimeve në kuadër të Planit të Investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor, e cila pritet t'i grumbullojë 1.2 miliard euro për investime.

KE-ja tha se kjo paketë do të mbështesë tetë investime të reja kryesore në ujësjellëse dhe kanalizime, në trajtimin e ujërave të zeza dhe në transportin hekurudhor, si dhe në inovacionin në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Investimet do të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me partnerë nga Ballkani Perëndimor dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

Paketa e investimeve prej 1.2 miliard eurosh përfshin 300 milionë euro grante të BE-së nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA III), kontribute shtesë dypalëshe nga vendet anëtare të BE-së dhe nga Norvegjia, kredi nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe kontribute nga ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sipas njoftimit, investimet e reja do

të zhvillohen bazuar në tri prioritetet e Planit të Investimit: Rindërtimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës së ujësjellësve dhe kanalizimeve në Mal të Zi dhe në Bosnjë-Hercegovinë; progresi në infrastrukturën hekurudhore në Korridorin 10, me lidhje të shpejtë ndërmjet Beogradit dhe Vëllica Plana, që mundëson qarkullim më të shpejtë të udhëtarëve dhe mallrave në rajon; si dhe mbështetje për sektorin e biznesit në rajon.

Kryetarja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka theksuar me këtë rast se plani i investimit për Ballkanin Perëndimor në vlerë 30 miliardë euro është përbushur me një paketë të re prej 1.2 miliard eurosh. “Kjo forcon lidhjet rajonale me infrastrukturë cilësore dhe na sjell më afër një-tjetrit, që është synimi ynë. Partnerët tanë të Ballkanit Perëndimor po e ndërtojnë të ardhmen e tyre evropiane. Këto investime, bashkë me reformat e nevojshme dhe me qasjen në tregun tonë të përbashkët, do t'i përgatisin ekonomitë e partnerëve



tanë për t'iu bashkuar bllokut”, tha ajo.

Komisioni Evropian miratoi Planin e Investimit për Ballkanin Perëndimor në vitin 2020, i cili përfshin periudhën 2021-2027. Kjo paketë synon ta nxisë rimëkëmbjen afatgjatë, ta përshejtojë transformimin e gjelbër dhe digital

dhe ta inkurajojë bashkëpunimin dhe konvergencën rajonale me BE-në.

Plani mbledh deri në 3 miliardë euro investime, duke përfshirë 9 miliardë euro grante të BE-së nëpërmjet IPA III gjatë një periudhe shtatëvjeçare. Nga kjo shumë, 5 miliardë euro janë dedikuar

përmes Planit të Investimeve Ekonomike për rajonin.

Deri më tani BE-ja ka miratuar programe për grumbullimin e deri në 17.5 miliardë euro investime në kuadër të Planit Ekonomik dhe Investimeve, duke përfshirë 5.4 miliardë euro në formën e granteve të BE-së.

“Ishim dhe do të jemi me Kosovën”, Ambasada Amerikane feston 248-vjetorin e Pavarësisë së ShBA-së

PRISHTINË, 3 KORRIK - Ambasada Amerikane në Kosovë ka organizuar pritje për nder të 248-vjetorit të Pavarësisë së ShBA-së. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin personalitete politike, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të medieëve. Në fjalën e tij, ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, tha se ata janë mbledhur për ta festuar 4 korrikun e vitit 1776.

Hovenieri tha se është krenar që vendi i tij është themeluar në bazë të idesë se “të gjithë burrat dhe të gjithë gratë janë krijuar të barabartë” dhe se “midis këtyre të drejtave janë jeta, liria dhe kërkimi i lumturisë.

Ai theksoi se edhe më tutje shoqëria amerikane vazhdon të udhëhiqet prej parimit të barazisë e lirisë. “Më 4 korrik 1776 etërit tanë themelues - që të gjithë burra - ia përkushtuan jetën, pasurinë dhe nderin e tyre të shenjtë parimeve dhe vlerave që vazhdojmë t'i ruajmë dhe

përpiqemi t'i jetojmë edhe sot. Jam krenar që vendi im u themelua në bazë të idesë se ‘të gjithë burrat (dhe do ta shfrytëzoj të drejtën e ambasadorit dhe të them edhe ‘të gjitha gratë’) janë krijuar të barabartë, se janë pajisur nga Krijuesi i tyre me të drejta të patjetërsueshme, se midis këtyre të drejtave janë jeta, liria dhe kërkimi i lumturisë. Këto janë fjalë të shenjta për amerikanët, por edhe ide të gjalla për të cilat vazhdojmë të veprojmë. Madje, edhe pse jo gjithmonë as ne e as etërit tanë themelues nuk i kemi përmbushur idealet tona më të mëdha, ne vazhdojmë ta përkufizojmë veten dhe shoqërinë tonë dhe të udhëhiqemi prej parimit të barazisë, lirisë dhe të qeverisë, e cila e merr autoritetin dhe pushtetin e saj përmes ‘miratimit të të qeverisurve’, tha Hovenieri.

Përveç kësaj, Hovenieri tha se ShBA-ja është krenare për mbështetjen që i ka dhënë popullit

të Kosovës për të vendosur paqe dhe siguri. Ai garanoi se ShBA-ja ishte dhe do të jetë me popullin e Kosovës, dhe shtoi se mbështetja amerikane është apartiake. “Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë krenare për mbështetjen që i kanë dhënë popullit të Kosovës që një çerek shekulli. Dëshiroj që ta dini se përkushtimi i ShBA-së është afatgjatë dhe apartiak. Shpresojmë të shohim përparim më të madh për të mirën e tërë popullit të Kosovës. Dhe unë dua të pohoj se Shtetet e Bashkuara ishin, janë dhe do të jenë me popullin e Kosovës derisa ecni përpara për ta përmbushur këtë vizion”, u shpreh Hovenieri.

Ndërkaq presidentja e vendit, Vjosa Osmani, tha se Dita e Pavarësisë së ShBA-së nuk është ditë krenarie vetëm për amerikanët, por edhe për popullin e Kosovës e të gjithëve në mbarë botën. Duke kujtuar rolin e ShBA-së në çlirimin e vendit, Osmani tha se 25 vjet më parë

bota demokratike e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara ndërhyri për t'u dhënë fund vuajtjeve të tmerrshme nga regjimit serb, duke theksuar se falë kësaj populli i Kosovës përjetoi bekimet e lirisë e të paqes. “Siç e them shpesh, kjo ditë e Pavarësisë nuk është vetëm një ditë krenarie për amerikanët, po një ditë mirënjohjeje të pamasë edhe për ne këtu në Republikën e Kosovës, po ashtu për të gjithë miqtë tuaj në mbarë botën. Në Kosovë shembulli juaj ndriçon rrugën tonë çdo ditë, duke forcuar aspiratat tona dhe duke forcuar vendosmërinë tonë për të krijuar një të ardhme të përcaktuar nga liria dhe drejtësia. Tek ju ne nuk shohim vetëm aleatin tonë më të madh, por gjejmë udhëzimit dhe udhëheqje ndërsa punojmë me këmbëngulje për t'i mbrojtur lirinë, demokracinë dhe drejtësinë për të gjithë. Ky vit shënon një moment historik të rëndësishëm në aleancën e qëndrueshme

midis dy vendeve tona. 25 vjet më parë bota demokratike e udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara ndërhyri për t'u dhënë fund vuajtjeve të tmerrshme njerëzore të kryera nga regjimi gjenocidal i Millosheviqit. Udhëheqja shembullore e Shteteve të Bashkuara siguroi që populli i Kosovës të përjetojë më në fund bekimet e lirisë dhe paqes së bashku me përgjegjësitë e mëdha që vijnë me të”, tha Osmani.

E para e vendit u shpreh e bindur se e ardhmja mes dy vendeve ka kapituj lavdie përpara. “Kontributi juaj ka qenë i rëndësishëm për arritjen e pavarësisë sonë, konsolidimin e demokracisë sonë, forcimin e aftësive tona mbrojtëse dhe ekonominë tonë, si dhe në rritjen e vazhdueshme të pozitës sonë ndërkombëtare. Ne ndajmë një të kaluar domethënëse, por jam e sigurt se shumë kapituj të tjerë lavdie janë përpara nesh”, deklaroi Osmani.



Hovenieri, mysafiri i parë i Haradinajt në selinë e re të AAK-së

PRISHTINË, 3 KORRIK - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradina, ka bërë me dije se ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ishte mysafiri i parë që ka vizituar selinë e re të AAK-së.

Haradinaj ka thënë se së

bashku me Hovenierin kanë folur për aktualitetin në Kosovë dhe për bashkëpunimin e ndërsjellë. “Me këmbë të mbarë e në shtëpinë e re, të nderuar që mysafiri i parë ishte Ambasadori Amerikan, Jeffrey Hovenier. Folëm për aktualitetin në Kosovë, për bashkëpunimin e

ndërsjellë, pa harruar mbështetjen jetike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në të gjitha fazat e lirisë e të shtetndërtimit të Kosovës! Me urime të ndërsjella edhe për Festën Kombëtare të Pavarësisë së Amerikës!”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.



Komuna e Prizrenit dhe UBT nëshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

PRIZREN, 3 KORRIK - Në kuadër të programit "UBT Start-Up School", kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka nënshkruar të mërkurën marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin UBT, që do të sigurojë projekte të përbashkëta në zhvillimin dhe zbatimin e programeve

për zhvillim ekonomik, urban dhe industrial të komunës së Prizrenit dhe aktiviteteve të tjera në interes të përbashkët. "Në këtë projekt, ku janë të përfshirë edhe GIZ-i e ITP-ja, UBT-ja do të ofrojë bursa studimi për të gjithë studentët e saj të komunës që do të përcaktohen me

vendim të veçantë, në mënyrë që të kontribuojë në edukimin cilësor të rinisë së Prizrenit, si dhe përmes programit Start-up do t'u mundësohet të rinjve tanë inovatorë të hapin biznese, duke pasur parasysh potencialin e tyre", ka thënë kryetari Totaj.



3 000 nxënës të arsimit parauniversitar, pjesë e programit "Arti në shkolla"



PRISHITINË, 3 KORRIK - 3 000 nxënës të arsimit parauniversitar nga 60 shkolla në nivel vendi kanë ndërvepruar deri më tani aktivisht me artin duke përfutur aftësi në aktivitete të ndryshme kulturore përmes zbatimit të fazës së tretë të programit "Arti në shkolla". Gjatë kësaj faze nxënësit kanë marrë pjesë në 250 aktivitete kulturore, duke u familjarizuar me të gjitha fushat e artit dhe kulturës, si dhe duke shprehur talentin e tyre në lexim, teatër, muzikë dhe trashëgimi kulturore.

Ministrisë së Kulturës në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe me institucionet e tjera partnere të kulturës në nivel qendror dhe lokal. Kontribut për realizimin e këtij programi janë duke dhënë edhe organizatat joqeveritare kulturore dhe artistët e pavarur. Derisa nxënësit shijojnë pushimet verore, MKRS-ja do ta vazhdojë punën për ta shtrirë edhe më tutje programin "Arti në shkolla" në arsimin parauniversitar të vendit tonë.

Aktiviteti i kontratës sociale nga USAID-i u diskutua edhe me drejtues dhe zyrtarë komunalë nga Rahoveci

RAHOVEC, 3 KORRIK - Nën kryetari i komunës së Rahovecit, Fatmir Iska, së bashku me drejtorë dhe zyrtarë komunalë, gjatë dy ditëve morën pjesë në punëtorinë për kontratën sociale, e cila u realizua nga USAID-i. Aktiviteti kishte për qëllim zvogëlimin e barrierave institucionale dhe strategjinë e rritjes së numrit të pjesëmarrjes publike. Ky projekt u mundëson zyrtarëve komunalë dhe pjesëtarëve të komunitetit që bashkë t'i

identifikojnë problemet kyçe me të cilat përballen, hartimin e planeve të veprimit për t'i adresuar ato probleme dhe të punohet përkrah njëri-tjetrit në zbatimin e tyre. Kontrata sociale në parim ka buxhetimin e projekteve me pjesëmarrje, duke bërë që qytetarët të jenë pjesë e vendimmarrjes. Këto praktika ndihmojnë në ndërtimin e një komuniteti më të fortë, më të qëndrueshëm dhe më të angazhuar.



Hyseni: Teatri i Gjilanit, i pari në Kosovë me çmim ndërkombëtar

GJILAN, 3 KORRIK - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me drejtorin e Kulturës, Kushtrim Zeqiri dhe drejtorin e Teatrit, Erson Zymberi, priten në takim aktorët e brezave të ndryshëm. Kjo pritje u bë në shenjë mirënjohje dhe respekti për punën,

përkushtimin dhe rezultatet e tyre. Kryetari Hyseni tha se Teatri i Gjilanit është i pari në Kosovë me çmim ndërkombëtar. "Ky ndoshta mund të cilësohet si suksesi më i madh mes shumë rezultateve të tjera të Teatrit të Qytetit të Gjilanit", tha Hyseni.



Gjini dhe ambasadori italian diskutojnë për zgjerimin e bashkëpunimit

GJAKOVË, 3 KORRIK - Kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka pritur në takim ambasadorin italian në Kosovë, Antonello De Riu. Bashkë ata biseduan për zhvillimet e fundit në Kosovë, me theks të veçantë për zhvillimet në nivelin lokal. "Dyanshëm shprehëm vullnetin që t'i

zgjerojmë mundësitë e bashkëpunimit tonë. E falënderoj ambasadorin De Riu për këtë takim sa konstruktiv aq dhe miqësor. Italia është ndër vendet kryesore në mbështetje të lirisë, shtetësisë dhe demokracisë së Kosovës", u shpreh kryetari Gjini.

Më pak çifte të kurorëzuara në vitin 2023 sesa një vit më parë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e kurorëzimeve për vitin 2023. Në vitin 2023 janë regjistruar 18 493 kurorëzime (brenda dhe jashtë Kosovës). Prej këtyre kurorëzimeve të regjistruara, 16 978 kurorëzime kanë ndodhur brenda territorit të Kosovës, kurse kurorëzime të cilat kanë ndodhur jashtë Kosovës janë regjistruar gjithsej 1 515. Krahasuar me vitin paraprak (2022) që ishin 17 863, në vitin

2023 janë kurorëzuar 16 978 apo (4.95 %) persona më pak, kurse jashtë Kosovës janë regjistruar 1 515 kurorëzime. Krahasuar me vitin 2022 (1627 kurorëzime), në vitin 2023 janë kurorëzuar 1 515 apo (6.9 %) më pak çifte.

Nga të dhënat statistikore, shihet se kurorëzime (brenda Kosovës) janë regjistruar më pak në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, gjithashtu (jashtë Kosovës) ka numër më të vogël të çifteve të kurorëzuara në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022. Sipas komunës ku ka ndodhur ngjarja, në Prishtina janë

regjistruar më së shumti kurorëzime 1 727 apo 9,3 %, në Prizren 1 597 apo 8,6 %, në Ferizaj 1 102 apo 6 % etj.

Personat e kurorëzuar sipas grupmoshës në vitin 2023, më së shumti raste ka te meshkujt e grupmoshës 25-29, në vendin e dytë grupmoshat 30-34 dhe në vendin e tretë grupmoshat 20-24, ndërsa te femrat më së shumti raste të kurorëzimeve ka grupmosha 20-24, vendin e dytë grupmosha 25-29 si dhe vendin e tretë grupmosha 30-34. Mosha mesatare e personave të kurorëzuar, të regjistruar gjatë vitit 2023, ishte 30 vjeç.



Ish-komandanti i KFOR-it: FSK-ja me ngritjen e kapaciteteve profesionale po ecën sigurt drejt integriteteve euroatlantike

PRISHTINË, 3 KORRIK - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletjënant Bashkim Jashari, së bashku me zëvendëskomandantin e FSK-së,

gjeneralmajor Enver Cikaqi, kanë pritur në takim ish-komandantin e KFOR-it, gjeneralin Erhard Buhler.

Gjatë takimit me mikun e

Kosovës, gjeneralin në pension Erhard Buhler, biseduan për të arriturat e Kosovës, në veçanti për të arriturat e FSK-së, me ç'rast gjenerali Buhler theksoi se FSK-ja

me zhvillimet dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale po ecën sigurt drejt integriteteve euroatlantike.

Ndërsa gjeneral Jashari e

falënderoi për mbështetjen e deritanishme dhe me këtë rast të dy gjeneralët u zotuan për bashkëpunim të mëtutjeshëm ndërmjet dy shteteve.

Rishpallet konkursi për rektor të UP-së, asnjëri kandidat nuk mori votat e nevojshme



PRISHTINË, 3 KORRIK - Votimi për rektorin e ri të Universitetit të Prishtinës ka dështuar edhe në raundin e tretë. Asnjëri nga kandidatët nuk ka siguruar shumicën e votave, për këtë arsye konkursi për rektor të UP-së rishpallet.

Kandidatët për rektor të UP-së

ishin: Isak Shabani, But Dedaj, Sefer Avdijaj dhe Faton Berisha. Anëtarët e Këshillit Drejtues të UP-së kanë votuar, mirëpo tre prej tyre kanë abstenuar.

Në raundin e parë: Faton Berisha dy vota, Isak Shabani katër vota. Në raundin e dytë: Faton Berisha tri vota, Isak

Shabani tri vota. Në raundin e tretë: Faton Berisha dy vota dhe Isak Shabani katër vota.

Aktualisht pozitën e rektorit të Universitetit të Prishtinës e mban Qerim Qerimi, i cili është zgjedhur më 21 nëntor të vitit 2022 dhe mandati i përfundon në shtator të këtij viti.

Policia dhe Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit nënshkruajnë marrëveshje të bashkëpunimit

PRISHTINË, 3 KORRIK - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim punë drejtorin e Agjencisë për Mbrojtje të Informacionit të Klasifikuar,

Emin Hoxhaj, me ç'rast kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve.

Ky takim është zhvilluar në frymën e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndërinstitu-

cionale me qëllim të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar dhe verifikimit të sigurisë, si dhe bashkërendimit të aktiviteteve të përbashkëta për fuqizimin e sigurisë shtetërore.



KEK-u del me njoftim pas protestës së banorëve të Shipitullës për shpronësimin e tokave

PRISHTINË, 3 KORRIK - Korporata Energjetike e Kosovës, pas protestës së banorëve të fshatit Shipitullë të komunës së Obiliqit, ka dalë me njoftim lidhur me shpronësimet e tokave. Sipas njoftimit, përvetësimi i tokës për nevojat xehetare (përmes Zhvendosjes/Shpronësimit) nga KEK bëhet vetëm bazuar në Planin Kryesor Xehetar dhe në legjislacionin në fuqi, përfshirë Kornizën e Politikave

të Zhvendosjes (KPZH), Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme në Kosovë dhe Ligjin për Miniera dhe Minerale (LMM). Sa iu përket shqetësimeve (pretendimeve) të banorëve në lidhje me procesin e shpronësimeve, KEK-u thotë se të gjitha i ka adresuar tek organet relevante të drejtësisë. "Prandaj, sa i përket përvetësimit të tokave dhe zgjerimit të minierave (për

arsye të tjera), që nuk janë në përputhje me Planin Kryesor Xehetar, dhe planet tjera operative, përsëri ju bëjmë të ditur se kjo çështje është përtej kompetencave dhe interesit të KEK sh.a", thuhet në njoftim. Dhjetëra banorë të fshatit Shipitullë të Obiliqit kanë protestuar para zyrave të KEK-ut në Prishtinë. Banorët kanë kërkuar takim me bordin e KEK-ut lidhur me shpronësimet e tokave.



Qeveria publikon hollësi rreth tenderit për ndërtimin e kapaciteteve të energjisë së erës prej 150 MW

PRISHTINË, 3 KORRIK - Ministria e Ekonomisë (ME) planifikon të zhvillojë tenderët e parë në Kosovë për energji prej erës për një kapacitet total prej rreth 150 MW, së bashku me Këshilltarin e Transaksionit të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (International Finance Corporation - IFC) si këshilltar kryesor i transaksionit, si dhe me përkrahje nga Aktiviteti për Energji të Qëndrueshme i USAID-it (ESA). Këto projekte do të zbatohen përmes dy tenderëve të njëpasnjëshëm me kapacitet prej rreth 75 - 100 MW secili, në lokacione të papërcaktuara. Secili tender do të përbëhet nga dy faza - kërkesa për Kualifikime (KPK) dhe Kërkesa për Propozime (KPP).



Me qëllim të informimit të ofertuesve potencialë me informacionin përkatës për kërkesat e parashikuara në mënyrë që ata të mund t'i ndërmarrin hapat e duhur për ta përgatitur aplikacionin e tyre për

tenderin e planifikuar, Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës ka publikuar një përmbledhje informative. Sipas njoftimit, ky dokument paraqet kriteret e parashikuara të cilat do të përcaktohen në fazën e

Kërkesës për Kualifikime (KPK) të tenderit, duke përfshirë kërkesat që kanë të bëjnë me fizibilitetin e projektit si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me përvojën dhe kapacitetet e ofertuesit. Megjithatë, thekson se kërkesat e renditura në përmbledhje nuk janë përfundimtare dhe mund të rishikohen si dhe të shtohen kritere shtesë në momentin e lansimit zyrtar të tenderit (ëve) kur të publikohet dokumentacioni përfundimtar i tenderit.

Kërkesa për kualifikime për tenderin e parë parashikohet të publikohet në tetor të vitit 2024 dhe ofertuesit e parakualifikuar do të ftohen t'i dorëzojnë propozimet në fillim të vitit 2025, ndërsa kërkesa për kualifikime për

tenderin e dytë pritet të publikohet në vitin 2025.

Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës planifikon t'i shfrytëzojë fondet nga Instrumenti për Aftësi Rimëkëmbëse dhe Qëndrueshmëri i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për të ndihmuar në zhvillimin e këtij kapaciteti për energji të erës prej 150 MW.

ME planifikon të bashkëinvestojë në projektet e energjisë së erës sipas skemës së Partneritetit Publiko-Privat (PPP), me qëllim të uljes së rrezikut për investitorët privatë. Projekteve të suksesshme do t'u jepet një Marrëveshje Afatgjatë për Blerjen e Energjisë Elektrike (MBE) e barazuar fizikisht.

Nënshkruhet kontrata për financimin e festës së vjeljes së rrushit "Hardh Fest 2024"



RAHOVEC, 3 KORRIK - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim Agron Sokolin, drejtor ekzekutiv i Shoqatës "Hardh Fest", me të cilin ka nënshkruar kontratën për financimin e festës së vjeljes së rrushit "Hardh Fest 2024", i cili do të mbahet më 6, 7 dhe 8 shtator 2024. "Kjo festë e madhe do të vazhdojë të mbetet një ndër ngjarjet më të mëdha kulturore, e cila do të bëjë bashkë adhurues të shumtë në një festë të rrallë për kulturën dhe trashëgiminë tonë bujqësore. Me mbështetjen e fortë të Komunës së Rahovecit, këtë vit, Festa e Vjeljes së Rrushit 'Hardh Fest', fuqishëm do ta dëshmojë që

vazhdon të kryesojë si një ndër festat më të mëdha që do t'i gërshetojë bashkë verën, rakinë dhe muzikën, të cilat festës i japin ngjyrim dhe identitet", ka thënë Latifi.

Ai ka theksuar se partneriteti i suksesshëm në mes të komunës së Rahovecit dhe Shoqatës "Hardh Fest" siguron një mbarëvajtje të suksesshme të festës e cila do të mbetet e paharrueshme për të gjithë qytetarët dhe vizitorët tanë. "Mbetemi të përkushtuar në promovimin e trashëgimisë sonë turistike, bujqësore dhe kulturore!", ka deklaruar kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi.

ZKA-ja dhe Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar me marrëveshje të bashkëpunimit profesional

PRISHTINË, 3 KORRIK - Auditorja e Përgjithshme Vlora Spanca dhe drejtori ekzekutiv i Institutit AAB për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar, Ylber Prekazi, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për zhvillimin e Programit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional. Marrëveshja ka për synim avancimin e njohurive dhe

aftësive profesionale të stafit të ZKA-së si dhe të sigurojë një platformë efektive dhe të qëndrueshme për zhvillimin dhe promovimin e praktikave të mira dhe standardeve të larta profesionale. Programi i EVP-ve do të përfshijë tema të rëndësishme për përmirësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të stafit të ZKA-së në fushën e

kontabilitetit dhe auditimit. Të pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes ishin edhe zëvendësauditoret i përgjithshëm Beza Halilaj, drejtori i përgjithshëm i ZKA-së, Safet Berisha, kryesuesi i Bordit të Institutit të AAB-së për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar, Sami Tahiraga si dhe koordinatori për Programe në Institut, Valbon Bytyqi.



Partnerë në krim



Një çerek shekulli më parë, Vladimir Putini fluturoi drejt Phenianit, për të firmosur një “traktat miqësie” me Kim Jong-il, që ndihmoi në ringjalljen e marrëdhënieve të Rusisë me Korenë e Veriut pa i detyruar të dyja palët t’i vijnë në ndihmë njëra-tjetres në rast të një sulmi ushtarak.

Me vizitën e tij të fundit, Putini ka shkuar më tej, duke firmosur një marrëveshje me Kim Jong-un që kujton paktin e sigurisë të vitit 1961, firmosur nga Bashkimi Sovjetik, gjatë Luftës së Ftohtë.

Por sot Rusia është e përfshirë në një luftë të nxehtë në Ukrainë, të cilën Putini e ka bërë prioritet të politikës së tij të jashtme, dhe një Kore e Veriut bërthamore është shndërruar në një litar shpëtimi për ushtrinë e tij, sa i përket municioneve.

“Traktati që Putini firmosi me Kim Jong-un ishte një rikthim në luftën e ftohtë, por sigurisht në luftën e ftohtë Koreja e Veriut nuk kishte armë bërthamore”, thotë Dr. Edward Howell, bashkëpunëtor i Chatham House. Edhe pse samiti i javës së kaluar kishte vite që përgatitej, ai shënoi një pikënisje në marrëdhëniet e Rusisë me Korenë e Veriut dhe Veriut nuk kishte armë bërthamore”, thotë Dr. Edward Howell, bashkëpunëtor i Chatham House. Edhe pse samiti i javës së kaluar kishte vite që përgatitej, ai shënoi një pikënisje në marrëdhëniet e Rusisë me Korenë e Veriut dhe Veriut nuk kishte armë bërthamore”, thotë Dr. Edward Howell, bashkëpunëtor i Chatham House.

Edhe pse samiti i javës së kaluar kishte vite që përgatitej, ai shënoi një pikënisje në marrëdhëniet e Rusisë me Korenë e Veriut dhe Veriut nuk kishte armë bërthamore”, thotë Dr. Edward Howell, bashkëpunëtor i Chatham House.

saj me Korenë e Veriut,” thotë Jamie Kwong, bashkëpunëtor në programin e politikës bërthamore në Carnegie Endowment for International Peace. Kim i shihte gjithë admirim teknologjinë hapësinore ruse dhe avionët luftarakë gjatë një samiti vitin e kaluar me Putinin, në lindjen e largët të Rusisë, dhe lista e tij e dëshirave mund të përfshijë teknologji që do të ndihmonin programet hapësinore dhe raketore të Koresë së Veriut, si dhe mbështetjen ekonomike dhe energjetike.

Qëllimi i menjëhershëm i Putinit është të zhvillojë një partneritet që ka furnizuar miliona predha artilerie, si dhe raketa balistike, të nevojshme për luftën e tij në Ukrainë. Por rrënjët e marrëdhënies shkojnë më thellë: të dy udhëheqësit janë rreshtuar në një koalicion gjithnjë e më anti-perëndimor dhe duken gjithnjë e më injorues ndaj kërcënimeve perëndimore.

Imazhi i Putinit – i cili dikur takonte rregullisht liderët amerikanë dhe evropianë – duke fluturuar për në Phenian, për t’u nderuar nga Kim ishte mbresëlënëse. Putini i dha Kimit një limuzinë të dytë Aurus të prodhuar nga Rusia, në një refuzim simbolik të sanksioneve që të dy palët kanë shkelur. “Dy udhëheqësve thjesht nuk u bëhet vonë,” tha Howell. “Tek Kim Jong-u, ai thjesht sheh një partner që është po aq delikuent sa ai.”

Zyrtarët e SHBA-së dhe NATO-s kanë shprehur shqetësim për mbështetjen e mundshme për programet raketore dhe bërthamore të Koresë së Veriut. Një kopje e traktatit të publikuar nga Koreja e Veriut rendiste në mënyrë eksplicite bashkëpunimin për “energjinë bërthamore paqësore”, ndërsa zyrtarët amerikanë i thanë NBC News se Rusia do të ofronte gjithashtu teknologji për të ndihmuar programin e nëndetëseve atomike të Koresë së Veriut.

Por analistët thanë se fusha e mbështetjes për programin bërthamor ushtarak të Koresë së Veriut mund të mbetet e kufizuar, pjesërisht për shkak se Rusia është hezituese për ndarjen e teknologjisë së ndjeshme.

Disa nga aspektet më shqetësuese të marrëveshjes janë më konvencionale: raportohet se tregtia në rritje e armëve midis dy vendeve mund të trimërojë Korenë e Veriut dhe të komplikojë planifikimin e luftës perëndimore në rastin e një konflikti të hapur në gadishullin Korean.

Matthew Miller, zëdhënës i Departamentit të Shtetit të SHBA, tha se ofrimi i armëve ruse për Phenianin “do të destabilizonte gadishullin Korean, natyrisht, dhe ndoshta ... do të shkelte rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së që vetë Rusia i ka mbështetur”. Sekretari amerikan i shtetit, Antony Blinken, dhe ministria e

jashtme e Koresë së Jugut thanë se traktati midis Rusisë dhe Koresë së Veriut përbën një “kërcënim serioz” për paqen dhe stabilitetin në gadishullin Korean. Blinken tha se SHBA do të konsideronte “masa të ndryshme” në përgjigje të paktit. “Ka shumë gjëra që Rusia mund t’i japë ende Koresë së Veriut në këtë moment, gjë që do të përmirësonte ndjeshëm aftësinë e Koresë së Veriut për të rindërtuar kundërpërgjigjen e saj konvencionale ushtarake,” tha Ankita Panda, bashkëpunëtor në programin e politikës bërthamore në Carnegie Endowment for International Peace.

Ai beson se rusët do të jenë të gatshëm të ndihmojnë Korenë e Veriut të përmirësojë aftësitë e saj të mbrojtjes ajrore, të furnizojë pjesë këmbimi dhe mirëmbajtjen e forcës ajrore të vjetëruar, si dhe të ndihmojë në modernizimin e marinës, duke përfshirë teknologjinë për nëndetëset bërthamore. Kjo do të “ndërlikonte në mënyrë thelbësore planifikimin për aleancën SHBA-Kore e Jugut, e cila do të mbështeste objektivat strategjike të Rusisë dhe Koresë së Veriut”, tha Panda.

Marrëveshja tashmë ka çuar në një përplasje të nxehtë mes Rusisë dhe Koresë së Jugut. Seuli javën e kaluar tregoi se mund t’i sigurojë Ukrainës armë vdekjeprurëse. Putini, nga ana tjetër, paralajmëroi se ky do të

ishte një “gabim i madh” dhe se Moska si përgjigje mund të marrë “vendime që nuk kanë gjasa të kënaqin udhëheqjen aktuale të Koresë së Jugut”.


Marrëveshja shihet gjithashtu si një dhimbje koke për Kinën, e cila është e kapur mes shqetësimeve për konkurrencën për ndikim në Korenë e Veriut dhe mundësisë që SHBA të zgjerojë mbështetjen e saj ndaj Koresë së Jugut si pasojë. Xi Jinping mund të kërkojë një samit me Kim deri në fund të vitit, tha Hoëell.

Takimi shënoi gjithashtu një pikë të re të ulët në përpjekjet ndërkombëtare për nxitjen e mospërhapjes bërthamore, dikur një fushë e rrallë bashkëpunimi midis Rusisë dhe SHBA-së.

Edhe në vitin 2017, pas aneksimit të Krimesë dhe akuzave për ndërhyrje ruse në zgjedhjet amerikane, SHBA-ja sërish e bindi Rusinë të votonte për sanksione të reja të OKB-së kundër Koresë së Veriut, megjithëse i zbuti ato.

Ato ditë tashmë kanë ikur. “Marrëveshja dërgon edhe një sinjal tjetër se Putini është i gatshëm të vendosë luftën kundër Ukrainës mbi të gjitha interesat e tjera, duke përfshirë promovimin dhe mbrojtjen e regjimit të mospërhapjes bërthamore – një regjim për vendosjen e të cilit, Bashkimi Sovjetik ndihmoi që në krye të herës”, thotë Kwong.

/ The Observer – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Edhe tre sportistë nga Kosova dhe katër nga Shqipëria në 'Paris 2024'



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 KORRIK - Lojërat Olimpikë "Paris 2024" fillojnë në këtë muaj dhe lajm i mirë për shqiptarët është se edhe shtatë sportistë të tjerë, tre nga Kosova dhe katër nga Shqipëria, do të marrin pjesë në Paris. Komiteti Olimpik i Kosovës ka njoftuar se atletja Gresa Bakraçi dhe notarët Hana Beiqi dhe Adell Sabović do ta përfaqësojnë Kosovën në këto lojëra. "Gresa Bakraçi do ta përfaqësojë sportin e atletikës në Lojërat Olimpikë Paris 2024. Atletja jonë do të garojë në disiplinën e 800 metrave. Gresa merr pjesë me ftesë të univerzalitetit, pas përzgjedhjes së bërë nga

komisioni përkatës i Federatës Ndërkombëtare të Atletikës (IAAF)", thuhet në njoftimin e KOK-ut. "Hana Beiqi dhe Adell Sabović do ta përfaqësojnë notin e Kosovës në Lojërat Olimpikë Paris 2024. Të dy notarëve u janë konfirmuar ftesat e univerzalitetit nga Federata Botërore e Sporteve të Ujit, falë më së shumti pikëve të FINA-s gjatë procesit kualifikues", thuhet në njoftim. Hana do të garojë në disiplinën 50 metra stil i lirë, ndërsa Adelli në 100 metra stil i lirë. Adelli është me prejardhje nga Peja, ndërsa karrierë ka bërë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sportistët e tjerë që e përfaqësojnë Kosovën në Lojërat e Parisit janë Distria Krasniqi, Lorian Kuka, Akil

Gjakova, Lorian Kuka, Laura Fazliu dhe Donjeta Sadiku. Shqipëria në Lojërat Olimpikë do të përfaqësohet me tetë sportistë. Përveç katër sportistëve që janë kualifikuar me normë olimpikë, listës kuqezi i shtohen edhe katër sportistë me ftesa. Ata janë atleti Franko Burraj, qitësja Manjola Konini si dhe notarët Greisi Koxhaku e Kaltra Meça. Këta katër sportistë u bashkohen tre mundësve Zelimkhan Abakarov, Islam Dudaev e Chermen Valiev si dhe atletes Luiza Gega, që janë kualifikuar në Olimpiadë duke kapur normën olimpikë. Së shpejti pritet që KOKSh-i t'i shpallë edhe sportistët që do ta mbajnë flamurin kuqezi në ceremoninë e hapjes së Lojërave Olimpikë (26 korrik).

SHKURT

Balkani transferon Geralb Smajlin

Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Ballkani, është përforcuar me Geralb Smajlin nga Vllaznia e Shkodrës. Smajli do të jetë zëvendësues i Armend Thaqit, i cili është larguar nga kjo skuadër pas përfundimit të kampionatit 2023/2024. "Skuadra jonë është përforcuar në krahun e djathtë edhe me një mbrojtës fantastik. Geralb Smajli, i cili ishte pjesë e Vllaznisë së Shkodrës, tashmë është veshur portokall e zi, duke nënshkruar kontratë me FC Ballkanin deri në vitin 2028. Ardhja e Geralbit do të jetë armë shtesë e jona në rrugëtimin evropian si dhe edicionin e ri të Superligës. Futbollistit i urojmë sa më shumë suksese drejt objektivave tona të përbashkëta", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Hajdari konfirmon largimin nga Feronikeli 74

Futbollisti i njohur Fiton Hajdari ka konfirmuar se nuk do të jetë më pjesë e skuadrës së Feronikelit 74. Ish-futbollisti i shumë skuadrave kosovare tash e tutje është futbollisti i lirë, derisa ka falënderuar të gjithë në klubin e Drenasit për bashkëpunim. "Të dashur miq, me anë të këtij postimi ju njoftoj se nuk jam më pjesë e Klubit FC Feronikeli 74. I falënderoj bashkëlojtarët dhe kryesinë e klubit për bashkëpunimin", ka shkruar Hajdari.

Dukagjini paraqet Pefqelin

Ish-futbollisti i Prishtinës, Mërgim Pefqeli, është paraqitur në skuadrën e Dukagjinit. Klubi nga Klina është i lumtur për transferimin e 30-vjeçarit, i cili ka një përvojë të madhe dhe do të jetë "armë" shtesë për skuadrën që do të drejtohet nga Ismet Munishi. "Ish-kapiteni i Prishtinës është përforcimi më i ri i klubit tonë. KF Dukagjini njofton se ka nënshkruar me mesfushorin me përvojë, që në dy sezonet e fundit ishte pjesë e Prishtinës, teksa karrierë ka bërë edhe te disa klube tjera. Përvoja dhe cilësitë e 30-vjeçarit pritet të jenë ndihmë e madhe për ne", thuhet në njoftimin e KF Dukagjini.

Muriq pritet të largohet nga Burnley

E ardhmja e portierit kosovar Arijanet Muriq vazhdon të jetë e paqartë. "Daily Mail" raporton se Arijanet Muriq mund të largohet këtë verë nga Burnley. "The Mail" raporton se Muriqi e ka bërë të qartë se do të dëshironte të largohej, kështu që ka një pritje që ai të lëvizë në këtë afat kalimtar. Pavarësisht dy gabimeve në ndeshjet kundër Evertonit dhe Brightonit, kosovari bëri përshtypje pasi më në fund mori shansin duke shkëlqyer me pritjet e tij. Muriqi, gjithashtu, përfundoi sezonin 2022/23 si portieri i sezonit në Championship pasi ndihmoi Burnleyn të fitonte titullin në drejtimin e Vincent Kompany. Celtic dhe Wolves janë dy skuadrat që e duan portierin dardan.

Pacoli: Politika po i rrezikon Lojërat Mesdhetare 'Prishtina 2030'

Prishtinë, 3 korrik - Kryetari i AKR-së, Behgjet Pacoli, ka ngrehur alarmin se politika është duke i rrezikuar Lojërat Mesdhetare të vitit 2030 që do të mbahen në Prishtinë. Sipas tij, politika po përpiqet ta luajë rolin kryesor në Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030".

Ai ka thënë se këshilli organizativ i këtyre Lojërave duhet të qëndrojë larg politikës, në të kundërtën rrezikohet që këto lojëra të anulohen. "Në nivel ndërkombëtar po dëgjoj se në Lojërat Mesdhetare që janë planifikuar të mbahen në

Kosovë në vitin 2030, politika po përpiqet ta luajë rolin kryesor. Komiteti Olimpik duhet të ketë kujdes që këshilli organizativ të qëndrojë larg politikës, në të kundërtën rrezikon që këto lojëra të anulohen", ka shkruar Pacoli në "Facebook".



Kosova U16 në përgatitjet finale për Kampionatin Evropian në Tiranë

PRISHTINË, 3 KORRIK - Kosova U16 në konkurrencën e meshkujve është duke u përgatitur për FIBA U16 Kampionatin Evropian, Divizioni C, i cili do të zhvillohet këtë vit në Tiranë. Përfaqësuesja e re, e udhëhequr nga trajneri Dion Pllana, me stafin e tij po

kalojnë nëpër një fazë intensive përgatitore, me qëllim që të arrijnë një performancë të shkëlqyer dhe dinjitoze në kampionat. Faza përgatitore ka filluar më 17 qershor në Prishtinë dhe është zhvilluar në mënyrën më të mirë të mundshme. Gjatë këtij procesi

basketbollistët e rinj kanë treguar përkushtim të madh dhe punë të palodhur për t'i përmirësuar aftësitë e tyre dhe për të përgatitur veten për kampionat. Përveç kësaj, gjatë vitit janë mbajtur grumbullime seleksionuese që u kanë dhënë mundësinë të gjithë lojtarëve ta tregojnë

kapacitetin dhe talentin e tyre. Kosova U16 është vendosur në Grupin B së bashku me San Marinon, Gjibraltarin dhe Armeninë. Ndeshjet në këtë grup pritet të jenë sfiduese, por "Dardanët" janë të vendosur t'i tregojnë cilësitë e tij dhe të luftojnë për çdo pikë në fushë.



Tetë skuadra në garë për trofeun, ja çfarë surprizash solli raundi i të 16-ave

Berlin, 3 qershor - Kampionati Evropian "Euro 2024" ka hyrë në fazën e tij më të nxehtë e padyshim më interesante. Kemi njohur tetë skuadrat më të mira të kontinentit, që do të luftojnë deri në fund me njëra-tjetrën për të shkuar në finalen e madhe të Berlinit, më 14 korrik. Po cilat ishin surprizat, çfarë të rejash solli faza e 1/8 si dhe cilët janë aktualisht kandidatët për ta ngritur trofeun? Faza e 1/8 të finaleve të "Euro 2024" nuk solli ndonjë surprizë, përveç eliminimit të Italisë nga Zvicra. Një eliminim që mund të konsiderohej edhe i pritur, për atë se çfarë kishin dhënë "azzurrët" deri në atë fazë. Një ekip që edhe ndaj Zvicrës luajti shumë keq duke e merituar eliminimin. Pjesa tjetër shkoi e gjitha sipas parashikimit, me kombëtares e mëdha, që ia dolën të siguronin një biletë për në fazën çerekfinale. Kështu Gjermania, Spanja, Anglia, Portugalia dhe Holanda u kualifikuan, megjithatë jo të gjitha



këto skuadra lanë "shije" pozitive me lojën e zhvilluar. Kështu Spanja, Gjermania dhe Holanda ishin skuadrat që bindën më shumë në lojë, por shumë specialistë të futbollit janë të mendimit se kundërshtarët që kishin përballë në këtë fazë nuk ishin në lartësinë e duhur. Ndaj është momenti që këto skuadra ta konfirmojnë forcën e tyre në çerekfinale, ku sigurisht Spanja dhe Gjermania duhet t'i "përplasni" brirët me njëra-tjetrën. Anglia dhe Portugalia ishin ekipet që vuajtën më shumë. Të dyja skuadrave nuk u mjaftoi koha e

rregullt për ta siguruar kualifikimin, me anglezët që fituan në kohën shtesë, ndërsa portugezët iu falën "ruletës ruse" të penalltive. Meritë e kundërshtarëve të tyre Sllovakisë dhe Sllovenisë, apo dobësia e këtyre kombëtareve, të cilat janë edhe pretendente për të shkuar deri në fund në këtë evropian? Faza çerekfinale mund të na japë përgjigje.

Në fund, por jo për nga rëndësia, Turqia, një skuadër luftarake, me grintë, e cila jep gjithçka në fushën e lojës. "Viktima" e radhës e tyre ishte Austria, një prej skuadrave më simpatike deri tani në evropian, gjë e cila rrit ndjeshëm edhe kuotat për vazhdimësinë te kjo skuadër. Gjithsesi diçka është e sigurt, të tetë skuadrat që kanë mbërritur deri në këtë fazë e kanë merituar plotësisht dhe janë të denja për të na dhuruar një fund kampionati të bukur dhe të paparashikueshëm.

SHKURT

Juve i shtohet garës për Brojën

Juventus është klubi i radhës që ka hyrë në garë për transferimin e sulmuesit shqiptar Armando Brojës. Reprzentuesi i Shqipërisë duket se gjatë kësaj vere përfundimisht do të largohet nga Chelsea. 22-vjeçari është një nga lojtarët më të kërkuar në tregun e kësaj vere. Pas Milanit dhe Napolit, tashmë edhe Juve është i interesuar për sulmuesin kuqez. Mediet italiane raportojnë se torinezët pëlqejnë sulmuesin shqiptar. Arkadiusz Milik pritet të largohet nga bardhezinjtë dhe sulmuesi shqiptar shihet si zëvendësuesi ideal i polakut. Juve, siç raportohet, synon ta transferojë lojtarin në formë huazimi. Përveç Milanit, Napolit dhe Juvës, Broja kërkohet edhe nga Evertoni dhe Wolfsburg.

Fiorentina synon transferimin e Asllanit, Interi kërkon 35 milionë euro

Kristijan Asllani është pjesë e Interit dhe dëshiron e tij është të mbetet pjesë e kësaj skuadre edhe në të ardhmen. Mirëpo kjo nuk e pengon skuadrën e Fiorentinës ta vazhdojë "luftën" për transferimin e mesfushorit shqiptar, i cili ka pak hapësira në skuadrën e Interit. Mediet italiane raportojnë se skuadra kampione e Italisë kërkon 35 milionë euro për ta lënë të lirë Asllanin. Forma e treguar në "Euro 2024" ka rritur ndjeshëm vlerën e mesfushorit, i cili ishte ndër pikat më të forta të Shqipërisë. Fiorentina nuk pritet të paguajë një shumë të tillë për Asllanin dhe për momentin drejtuesit e kësaj po qëndrojnë në heshtje.

UEFA nis hetimet për festën e Demiralit

Merih Demiral ishte heroi i Turqisë, pasi shënoi dy gola në ndeshjen ndaj Austrisë (2-1). Megjithatë festa e Demiralit ka bërë që UEFA t'i nisë hetimet ndaj tij. Ai festoi duke bërë një simbol ultranacionalist turk. Autoritetet gjermane e konsiderojnë këtë grup antisemitik dhe racist. "Në lidhje me ndeshjen e raundit të 1/8 të Kampionatit Evropian të UEFA-s 2024 ndërmjet Austrisë dhe Turqisë të luajtur më 2 korrik 2024 në Lajpcig, Gjermani, është hapur një hetim në përputhje me nenin 31(4) të Rregullores Disiplinor të UEFA-s në lidhje me pretendimet e papërshtatshme dhe sjelljet e lojtarit të Federatës Turke të Futbollit, Merih Demiral", thuhet në njoftimin e UEFA-s.

De Ligt dëshiron t'i bashkohet Unitedit

Manchester Unitedi është i vetmi klub me dritën jeshile nga Matthijs de Ligt për të vazhduar dhe avancuar në bisedime, siç qëndrojnë gjërat. Nuk ka bisedime në vazhdim në mes të agentit dhe PSG-së pasi De Ligt i jep përparësi Manchester Unitedit. "Djajtë e Kuq" janë duke negociuar me Bayernin për strukturën e marrëveshjes. Aventura e De Ligt te Bayerni nuk doli ajo të cilin e mendoi holandezi dhe tani po shikon një mundësi të re. Edhe te Juventus, De Ligt nuk e arriti asnjëherë potencialin që të gjithë e panë sa ishte pjesë e Ajaxit.

U shpall kampion në NBA, ekipi i Bostonit del në shitje

BOSTON, 3 KORRIK - Si një rrufe në qiell të hapur ka ardhur lajmi se skuadra e Boston Celticsit pritet të ndryshojë së shpejti pronar. Një vendim që vjen vetëm tri javë nga fitimi i titullit të 18 kampion në NBA, një rekord. Wyc Grousbeck dhe Steve Pagliuca, që mbajnë shumicën e aksioneve të klubit, kanë njoftuar se kanë nxjerrë në shitje klubin historik. Kur blenë Celticsi në vitin 2002, 22 vjet më parë, ata paguan 360 milionë dollarë. Sot mund ta shesin klubin për më shumë se 5 miliardë dollarë. Duket se çështja e rinovimit të kontratave ka sjellë këtë tërmet në klub. Jaylen Brown nënshkroi një kontratë pesëvjeçare me vlerë 285



milionë dollarë verën e kaluar. Jayson Tatum nënshkroi një rinovim të saj me 314 milionë dollarë deri në fund të sezonit 2029-2030. Kjo është edhe kontrata më e pasur në historinë e NBA-s. Më herët kishte rinovuar edhe Derrick White, 4 vjet për 125 milionë. Dhe, meqenëse ka një kufi pagash për t'u përmbushur, i vendosur në 140 milionë dollarë për sezonin e ardhshëm, Celticsi do të detyrohet të paguajë taksashtesë.

Në sezonin 2025-2026, ata që e kalojnë kufirin prej 20 milionë do ta shohin rritjen e taksës së luksit me 40 %, madje me 52.6 % për ata që e kalojnë për të dytën vit radhazi. Pra, qindra miliona dollarë që dalin. Kjo është ndoshta arsyeja pse Pagliuca, i cili është aksionar i shumicës së Atalantas, dhe Grousbeck ka vendosur të nxjerrin Celticsin në shitje. Nuk dihet ende se cilët mund të jenë blerësit e ardhshëm. Ndryshimi i pronësisë do të jetë gradual dhe do të bëhet në fund të vitit ose në fillim të 2025-s, me Grousbeck që do të mbetet në rolin e pronarit referues deri në mbylljen e dytë, që do të bëhet në vitin 2028.

Gundogan: Kundër Spanjës nuk duhet të fshihemi

Të gjithë presin me padurim ndeshjen çerekfinale të "Euro 2024", ku do të përballen mes tyre Gjermania organizatore dhe Spanja, deri tani e pathyeshme në këtë turne. Një finale e parakohshme, ku spektakli s'do

të mungojë. Ilkay Gundogan, mesfushori i Gjermanisë, ka folur për këtë ndeshje, duke dhënë opinionin e tij për mënyrën se si do të luajë kombëtarja vendase: "Unë nuk mendoj se duhet të fshihemi nga

Spanja, pasi edhe ne gjithashtu kemi cilësi të mëdha". "Spanjollët na respektojnë më shumë sesa e pranojnë publikisht. Yamal? I veçantë, por duhet thënë se ai ka ende shumë për të mësuar. Problemi është se

nëse e humbet topin shumë shpejt, ai bëhet lojtari kryesor i tranzicionit për Spanjën", ka thënë Gundogan për shokun e skuadrës te Barcelona. Duke folur më tej për këtë ndeshje, ai shtoi: "Në këtë ndeshje do të

përballen me njëra-tjetrën dy nga ekipet më të mira të këtij Kampionati Evropian. Nuk ka më sekrete, do të jetë lojë e hapur dhe do të fitojë ai që gabon më pak e shfrytëzon më mirë rastet e krijuara".

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Lab Oil" shpk, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Deponim të Pet Kokut, në Z.K. Preoc, Graçanicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.08.2024 në ora 10:00 në SHFMU "Ditët e Minatorit" Kishnicë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Lab Oil" shpk, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Deponim të Pet Kokut, në Z.K. Preoc, Graçanicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://zoom.us/j/97428715600?pwd=a1syHrEk4KNHTf5LKrXvHK7bUabsUr.1>

Meeting ID: 974 2871 5600
Passcode: 12345

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Lab Oil" shpk, Graçanicë, Deponim të Pet Kokut, në Z.K. Preoc, Graçanicë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Beton Group" shpk. Malishevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Bazën e Prodhimit të Betonit- Linja 2, Z.K. Bellanicë, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.08.2024 në ora 10:00 në ShFMU "Naim Frashëri" Fshatin Banjë, Komuna Malishevë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Beton Group" shpk. Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Bazën e Prodhimit të Betonit- Linja 2, Z.K. Bellanicë, Malishevë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943
Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Beton Group" shpk. Malishevë, Bazën e Prodhimit të Betonit- Linja 2, Z.K. Bellanicë, Malishevë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Thirrja për aplikim (DHËNJË TË OFERTËS)

"DRAGAN VASIC" B.I. me Numer Unik.Biz: 810725939 me seli te biznesit në Adresa: Zebince pn komuna Novoberde, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për mallrat/punët/shërbime këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:

1. Traktor 102 HP 4x4 me kabine dhe klime,
2. Mbjellse gruri me gjersi 3 m rendore ,
3. Energjia Solare 3.5 kw

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek "DRAGAN VASIC" B.I. pronar "DRAGAN VASIC (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorezimit të Ofertave 10 ditë nga data e pranimit te ftesave per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: Zebince pn komuna Novoberde

Për Informata Shtesë tel: +383 45 282 968 dhe në email adresën: vasicdragan249@gmail.com

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Euro Via" shpk, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e argjilës në zonën kadastrale Serbicë e Poshtme, komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.08.2024 në ora 11:00 në Objektin e Komunës së Prizrenit - Zyra e Administratës, do të organizohet debat publik nga Kompania "Euro Via" shpk, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për shfrytëzimin e argjilës në zonën kadastrale Serbicë e Poshtme, komuna e Prizrenit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM


<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b25251MvQmPhd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Euro Via" shpk, Prizren, për shfrytëzimin e argjilës në zonën kadastrale Serbicë e Poshtme, komuna e Prizrenit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Lab Oil" shpk, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Deponim të Pet Kokut, në Z.K. Preoc, Graçanicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.08.2024 në ora 10:00 në SHFMU "Ditët e Minorit" Kishnicë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Lab Oil" shpk, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Deponim të Pet Kokut, në Z.K. Preoc, Graçanicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://zoom.us/j/97428715600?pwd=a1syHrEk4KNHTf5LKrXvHK7bUabsUr.1>

Meeting ID: 974 2871 5600
Passcode: 12345

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Lab Oil" shpk, Graçanicë, Deponim të Pet Kokut, në Z.K. Preoc, Graçanicë.

<https://mmpi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
 Sallon Depilimi Lumë's Details
 lumescdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dielli Zhaveli nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës të lëshuar nga Gjimnazi "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Shkëndije Hajdari nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10,11,12 si dhe diplomën e SH.M.L.EM "KEKA MED", Klinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

MEKA

 HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L